

*✓-Vetore zyrtare
Nr. 83 datë 6/07/2007*

VENDIM
Nr.377, datë 20.6.2007

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË MJEDISEVE NGA ISH-KOMISIONI I LETRAVE ME VLERË TE KËSHILLI KOMBËTAR I KONTABILITETIT DHE TE BURSA E TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mjediset, 3 zyra në pjesën veriore, në përgjegjësi administrimi të ish-Komisionit të Letrave me Vlerë, t'i kalojnë në përgjegjësi administrimi Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, për t'u përdorur sipas planimetrisë, që i bashkëlidhet këtij vendimi.


2. Mjediset, 3 zyra në pjesën jugore, në përgjegjësi administrimi të ish-Komisionit të Letrave me Vlerë, t'i kalojnë në përgjegjësi administrimi Bursës së Tiranës, për t'u përdorur sipas planimetrisë, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit dhe Bursës së Tiranës u ndalohen t'ua ndryshojnë destinacionin këtyre pronave, t'i tjetërsojnë ose t'ua japin në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Bursa e Tiranës, sh.a., Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



17. TOTAL SAVED